

## Vlerësimi dhe promovimi në klasat im 1-9.

Rregullore për vlerësimin dhe promovimin në shkollën popullore

e datës 7 dhjetor 2011

(Rregullore vlerësimi, Beurteilungsreglement, RB 10.1135)

## Rregullat më të rëndësishme për prindërit

- |   |   |
|---|---|
| 1. Si vlerësohet fëmija ynë?  | 2 |
| 2. A mund të kalojë fëmija ynë në një klasë më lart?                | 3 |
| 3. Cilat janë të drejtat dhe detyrimet tona në fushën e vlerësimit? | 4 |

Tekstin e plotë të rregullores për vlerësimin e gjeni në internet  
në adresën [www.ur.ch](http://www.ur.ch)

> Shkruani fjalën kërkuese „Rechtsbuch“ (djathtas lart)

> Klikoni „3. Rechtsbuch online“

> Shkruani 10.1135

## 1. Si vlerësohet fëmija ynë?

Mësimi dhe vlerësimi janë të pandara. Vlerësimi e mbështet mësimin, zhvillimin e personalitetit si dhe vendimet për të ardhmen. Vlerësimi respekton kompetencën përmbajtësore, personale si dhe sociale.<sup>1</sup>

*Parimi  
(Neni 3)*

Fëmija juaj vlerësohet në tërësi. Tërësia e vlerësimit bëhet përmes fomave të ndryshme të vlerësimit:

- vlerësimi gjatë mësimit (Rezonanca e mësuesve rreth procesit mësimor dhe suksesit; provimet);
- biseda vjetore me prindërit;
- dëftesa;
- sistemi i testimit i quajtur „Stellwerk“ në klasën e 8-të dhe të 9-të<sup>2</sup>.

*Format e vlerësimit  
(Neni 3 dhe 4)*

Personeli mësimor i klasës zhvillon nga klasa e 1-rë deri në klasën e 9-të, njëherë në vit një bisedë vlerësuese me prindërit dhe fëmijën. Kjo bisedë bazohet në një formular vlerësimi të paracaktuar.

*Biseda me prindërit  
(Neni 5 dhe 6)*

Biseda vlerësuese shërben për informimin e prindërve dhe të fëmijës rreth nivelit dhe progresit mësimor në kompetencat përmbajtësore, personale dhe sociale. Ajo i shërben mbështjetjes së fëmijëve si dhe përfshirjes së mësuesve në procesin mësimor. Kjo bisedë ndihmon gjithashtu bashkëpunimin mes palëve dhe i shërben planifikimit të rrugës së mëtejme arsimore.

Personeli mësimor i klasës lëshon në fund të çdo simesteri nga një dëftesë për secilin nxënës. Dëftesa është një tregues i suksesit mësimor në kompetencat përmbajtësore, personale dhe sociale si dhe i së ardhmes së fëmijës në sistemin arsimor. Dëftesa shërben edhe për konstatimin e mundësisë së kalimit të nxënësit një klasë më lart (provomimit).

*Dëftesa  
(Neni 7 dhe 8)*

Vlerësimet në kompetencat përmbajtësore në dëftesat e klasës së 1-rë dhe të 2-të shënohen si „ka arritur qëllimin e mësimit“ ose „nuk ka arritur qëllimin e mësimit“<sup>3</sup>. Nga klasa e 3-të deri në të 9-të shënohen notat.

*Vlerësimi i kompetencës  
përmbajtësore  
(Neni 9 deri 12)*

Kemi skalën e mëposhtme të notave: 6 = shumë mirë, 5 = mirë, 4 = mjaftueshëm. Notat nën 4 përshkruajnë rezultate të pamjaftueshme. Në dëftesë shënohen nota të plota ose gjysma (5.5, 4.5 etj.).

Kompetenca personale dhe sociale vlerësohet në bazë të tri kriterëve.

Kompetenca personale . pjesëmarrja aktive në mësim  
· puna e kujdesshme  
· puna e pavarur

Kompetenca sociale . puna e përbashkët me të tjerë  
· respektimi i rregullave  
· respekti ndaj të tjerëve

Vlerësimi bëhet me fjalë, konkretisht

- Është tejkaluar qëllimi
- Është arritur qëllimi
- Qëllimi është arritur pjesërisht
- Qëllimi nuk është arritur

Zakonisht jepet vlerësimi „Është arritur qëllimi“. Nëse ka parashikime që një ose disa prej kriterëve do të vlerësohen si të pamjaftueshme, atëherë personeli mësimor i klasës vë kontakt me prindërit dy muaj para përfundimit të simestrit.

*Vlerësimi i kompetencës  
personale dhe sociale  
(Neni 13 dhe 14)*

## 2. A mund të kalojë fëmija ynë në një klasë më lart?

Në shkollën fillore si dhe në shkollën e lartë (Oberstufe) separuese dhe kooperative (përfshi shkollat e mesme, respektivisht klasat bazë A dhe B) duhet konstatuar kalimi në një klasë më të lartë (promovimi). Vendimtare për këtë është dëftesa në fund të vitit..

Në shkollën e lartë të integruar nuk është i nevojshëm konstatimi i promovimit; në këtë rast nxënësit kalojnë vetëm nga një nivel në tjetrin.

*Promovimi  
(Neni 25)*

Lëndët promovuese janë:

- në shkollën fillore: gjermanishtja, matematika, anglishtja dhe njeriu & natyra;
- në shkollën e lartë: gjermanishtja, matematika, anglishtja, frëngjishtja, gjeografia, historia/politika dhe dituri natyre.

*Lëndët promovuese  
(Neni 26 dhe 30)*

*Promovimi në shkollën fillore si dhe në shkollën e lartë të separuar*

Në së paku dy nga tre fushat e promovimit duhet të jenë arritur rezultate të mjaftueshme. Rezultati i mjaftueshëm do të thotë: „Është arritur qëllimi“ (në klasën e parë dhe të dytë) dhe së paku nota 4 (nga klasa e tretë deri në të nëntën).

- në gjermanisht dhe në anglisht dhe frëngjisht;
- në matematikë;
- në lëndën njeriu & natyra, respektivisht në dituri natyre ose në gjeografi/histori/politikë.

*Arritja e promovimit  
(Neni 27, 31 dhe 32)*

*Promovimi në shkollën e lartë kooperative (Klasa bazë A)*

Duhet të plotësohen dy kushtet e mëposhtme:

- mesatarja e notave në dëftesë në lëndët gjermanisht, dityri natyre dhe gjeografi duhet të jetë së paku 4.0;
- së paku dy lëndë nivelore t'i përkasin nivelit A (matematikë, anglisht, frëngjisht).

Nëse rrezikohet kalimi i një fëmije në një klasë më lart, atëherë prindërit njoftohen me shkrim nga personeli mësimor i klasës më së voni deri në fillim të simestrit të dytë.

Nëse nuk arrihet promovimi, atëherë

- ose përshtatet individualisht përmbajtja e mësimimit ose përsëritet klasa (shkolla fillore)
- ose kalohet nga Sek ose klasa bazë A në shkollën e mesme (Real), respektivisht në klasën bazë B, ose përsëritet klasa (shkolla e lartë).

Të dy mundësitë duhet t'i bisedoni me personelin arsimor dhe pastaj të vendosni për njërin prej tyre..

*Mosarritja e promovimit  
(Neni 28, 31 dhe 32)*

Gjatë kohës së detyrimit shkollor mund të përsëritet klasa gjithsej vetëm dy herë, ndërsa e njejta klasë mund të përsëritet vetëm një herë.

*Përsëritja e klasës  
(Neni 39)*

Kur përshtatet përmbajtja mësimore si dhe në shkollën e lartë të integruar, nxënësit zakonisht nuk e përsërisin klasën. Përrjashtimet janë të mundura.

<sup>1</sup> *Kompetencë përmbajtësore* është aftësia për të përdorur dijen e nevojshme dhe aftësitë e kërkuara për kryerjen e detyrave konkrete. *Kompetencë personale* është aftësia për të zgjidhur probleme dhe detyra të ndryshme në mënyrë të pavarur, të orientuar dhe kompetente. *Kompetencë sociale* është aftësia për të kuptuar të tjerët, për të qenë bartës i një bashkësie në tërësi ose i një pjese të saj.

<sup>2</sup> Në simestrin e dytë të klasës së 8-të si dhe në fund të klasës së 9-të zhvillohet me të gjithë nxënësit testi „Stellwerk“. Në klasën e 8-të i shërben përcaktimit të gjendjes, ndërsa në klasën e 9-të i shërben konstatimit të nivelit mësimor në fund të periudhës së detyrimit shkollor.

<sup>3</sup> E njejta gjë vlen për fëmijët, të cilët në një ose disa lëndë kanë përmbajtje mësimore të përshtatur. Edhe aty vlerësimet jepen në lëndët përkatëse me përshkrimet „Është arritur qëllimi“ ose „Qëllimi nuk është arritur“.

### 3. Cilat janë të drejtat dhe detyrimet tona në fushën e vlerësimit?

Ju gëzoni të drejtën,

- të informoheni rreth nivelit dhe përparimeve të fëmijës suaj,,
- t'ju krijohet mundësia të shihni punët e vlerësuara të fëmijës suaj,
- të zhvilloni biseda personale me mësuesit

*Bashkëpunimi  
me shkollën*

Ju jeni i detyruar,

- të bashkëpunoni me shkollën dhe me shërbimet shkollore,
- të shikoni dhe nënshkruani dëftesat e fëmijës suaj,
- t'iu përgjigjeni ftesave të mësuesve për bisedat vlerësuese.

(Neni 30 dhe 31 i Rregullores për Shkollat të datës 22 prill 1998, RB 10.1115)

Me nënshkrimin tuaj ju vërtetoni që e keni parë dëftesën dhe jo që pajtoheni me vlerësimet e bëra në dëftesë. Nëse keni pyetje ose nuk pajtoheni me vlerësimet, atëherë kontaktoni mësuesin kujdestar të fëmijës suaj.

*Vënia në dispozicion  
e dëftesave*

Problemet dhe kundërthëniet në shkollë duhet përpjekur të sqarohen dhe zgjidhen në radhë të parë në bisedë të lirë.

*Problemet zgjidhen  
duke biseduar*

Prindërit gëzojnë të drejtën të paraqiteni para këshilltarit të shkollës, respektivisht tek drejtuesit e shkollës, nëse e ndiejnë veten në disavantazh ose nëse mendojnë që janë shkelur të drejtat e tyre. Këshilltari i shkollës ose drejtoria mund t'ju tregojnë se cila është procedura ligjore që mund të ndiqni në këte rast.

*E drejta për bisedë*

(Neni 68 dhe 69 i Ligjit për Shkollat të datës 2 mars 1997, RB 10.1111)

Tekstin e plotë të rregullores për vlerësim e gjeni në internet në adresën [www.ur.ch](http://www.ur.ch)

- > Shkruani fjalën kërkuese „Rechtsbuch“ (djathtas lart)
- > Klikoni „3. Rechtsbuch online“
- > Shkruani 10.1135